Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/255
Datë 24.06.2016

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 06.11.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin dhe validimin e Liceu "Don Bosko", në Prishtinë për periudhën 06.11.2015 deri 06.11.2018 për të ofruar:

1.1 Teknologji Informative dhe të Komunikimit, niveli IV sipas KKK.

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Kompjuterët në sallat kompjuterike kanë të instaluar sistemin operativ Ëindoës 7 dhe paketën e aplikacioneve të MS Office 2010 të pa licencuar. Rekomandohet që sistemi operativ dhe pako e aplikacionit të MS Office të jenë të licencuar.
- Edhe përkundër faktit që QSE "Don Bosko" nxënësit i ofron arsim profesional në fushën e teknologjisë informative dhe të komunikimit ashtu që ai/ajo të shtojë mundësitë e gjetjes së punës, evidente është se mungon komunikim i strukturuar me bizneset. Rekomandohet që QSE "Don Bosko" të luaj rol aktiv në këtë çështje ashtu që të kontribuohet në rritjen e mundësive të punësimit të nxënësve.
- QSE "Don Bosko" posedon dhomë të serverit dhe serverë por nuk posedon intranet. Rekomandohet që të zhvillohet Intraneti ashtu që përmes tij krahas informimit dhe komunikimit të brendshëm do të mund t'a ofrojnë edhe bibliotekën digjitale për nevojat e nxënësve.

- QSE "Don Bosko" posedon shtatë (7) salla të kompjuterëve për punë praktike të nxënësve, ku secili kompjuter është i lidhur me monitorin e mësimdhënësit. Në sallë vërehet që ka rrjet të hapësirës lokale (LAN) porse jo të gjithë kompjuterët janë të kyçur në rrjet. Rekomandohet që të gjithë kompjuterët të lidhen në rrjet funksional përmes të cilit kandidatët të kenë qasje në Internet. Njëkohësisht të aplikohen filtra për qasje në Internet ashtu që nxënësit të qasen kryesisht në ueb faqe me përmbajtje edukative.
- QSE "Don Bosko" gjatë periudhës Qershor – Korrik organizon punëtori për përditësimin e njohurive të mësimdhënësve si dhe zhvillimin profesional të tyre. Pavarësisht, në tre vitet e fundit asnjë nga mësimdhënësit nuk ka vijuar, ndjekur apo marrë pjesë në ndonjë trajnim profesional. Rekomandohet që të alokohet buxhet i posaçëm për zhvillimin profesional të mësimdhënësve me mundësi pjesëmarrje në trajnime në çdo periudhë të vitit. Njëkohësisht, mësimdhënësi i TIK-ut të trajnohet dhe certifikohet në ECDL versionin 5.0.
- Në objektin e QSE "Don Bosko" edhe pse në masë të konsiderueshme ekziston sinjalizimi për orientim të brendshëm, sërish rekomandohet që të riorganizohet sinjalizimi i orientimit në hapësirën e brendshme të objektit ashtu që hapësirat e pambuluara të identifikohen me sinjalizim.
- Në formatin ekzistues të arsimimit QSE "Don Bosko" pohon se e ka të përfshirë praktikën në mjedis të biznesit. Pavarësisht, nxënësit pohojnë se nuk kanë marrë pjesë në një praktikë të tillë dhe se ata janë shumë të interesuar që të merrnin pjesë në praktika të tilla. Ndaj duke e parë disponimin e nxënësve te cilët favorizojnë mundësinë qe krahas arsimit profesional të kenë mundësinë edhe te mbajtjes se praktikës se paku një javë brenda vitit shkollor ne ndonjë biznes apo organizatë, rekomandohet menaxhemti i QSE "Don Bosko" të tregohet i dëgjueshëm karshi kërkesës së nxënësve ashtu që të organizon mësimin praktik në mjediset e bizneseve. Aktualisht menaxhmenti nuk ka ndonjë kontratë ose marrëveshje me shkrim me ndonjë institucion nga sektori privat ose publik për një praktikë të tillë të nxënësve në fushën e TIK-ut.
- Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm i stafit të QSE "Don Bosko" në formatin elektronik realizohet përmes postës elektronike private. Rekomandohet që stafi i QSE "Don Bosko" të përdorin e-Postën zyrtare për komunikim elektronik të brendshëm dhe të jashtëm.
- Edhe përkundër faktit që QSE "Don Bosko" ofron ambient komod, kurikulë profesionale dhe raporte të njerëzishme dhe profesionale të stafit me nxënësit, sërish nxënësit kanë ankesë në orarin i cili është i gjatë brenda ditës. Rekomandohet që së bashku me nxënësit dhe prindërit e tyre të shqyrtohet mundësia e ri formatimit të orarit mësimor për nxënësit.
- Edhe pse menaxhmenti dhe mësimdhënësit e QSE "Don Bosko" janë të hapur për t'i biseduar dhe shqyrtuar kërkesat dhe ankesat e nxënësve dhe të prindërve të tyre, në ambientin e QSE "Don Bosko" mungon kutia e ankesave/falënderimeve. Rekomandohet menaxhmenti që të vendosin kutinë e ankesave/falënderimeve në hapësirë të dukshme brenda objektit.
- Në sallat e kompjuterëve të QSE "Don Bosko" vërehet prezenca e teknologjisë moderne siç janë kompjuterët desktop me monitor të hollë krahas atyre me gyp katodik. Pavarësisht, në disa nga sallat rekomandohet menaxhmenti dhe mësimdhënësit që të

shikojnë mundësinë e riorganizimit të pajisjeve kompjuterike, tavolinave, karrigave dhe pajisjeve shoqëruese ashtu që të lirohet hapësirë. Po ashtu, të shikohet mundësia e instalimit të pajisjeve për ventilim të ajrit si dhe të ndërrimit të karrigave prej druri me karriga të cilat pjesën e poshtme (ulësen) e kanë ergonomike.

- (Afati kohor i këtyre kushteve: 31.01.2016)

1. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1 Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- Liceu "Don Bosko", në Prishtinë;
- AKK.



Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani